

K.U.D 327 (4/9:496.5) "1913"
94 (496.5).085.1)

Ma. Elena KOCAQI

ULTIMATUMI AUSTRO-HUNGAREZ I TETORIT TË 1913 PËR TËRRHEQJEN E TRUPAVE USHTARAKE SERBE NGA SHQIPËRIA

Gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër u arrit një kompromisi i vështirë midis Fuqive të Mëdha për përcaktimin e kufijve të shtetit të ardhshëm shqiptar. Si rezultat i mosmarrëveshjeve që u krijuan këto fuqi arritën deri aty sa të kërcënoni njëra –tjetrën me luftë Evropiane dhe Botërore. Austro-Hungaria luftoi për të themeluar një shtet shqiptar që ajo e shikonte si interesin e saj vital me qëllim që të mos lejonte Serbin që të dilte në Adriatik dhe që Italia të mos e shndërronte këtë det në një liqen të vetin me vendosjen e saj në bregun tjetër. Monarkia dëshironte një Shqipëri të bashkuar etnikisht por që ndeshi në kundërshtimin Ruso-Francez që kishte aleat sllavët e Ballkanit të cilët ishin për zhdukjen nga harta politike të shtetit shqiptar. Ekuilibri midis këtyre ekstremeve ishte krijimi i Shqipërisë si kërkesë e panegociushme e Austro-Hungarisë por copëtimi i saj si kërkesë e panegociushme e Rosisë. Kështu, krijimi i shteti shqiptar ishte rezultat i kompromisit të arritur midis Fuqive të Mëdha dhe territori i tij ishte pika ku u arrit një ekuilibër forcash midis këtyre fuqive. Palët i bën njëra tjetrës lëshime për të mos çuar shtetet e tyre në luftë.

Pasi u shpërnda Konferenca e Ambasadorëve në gusht të 1913 doli problemi i zbatimit të vendimeve të saj. Shtetet e vogla Ballkanike fillua të sfidonin Fuqitë e Mëdha dhe veçanërisht Austro-Hungarinë që kishte investuar të gjithë fuqinë e saj diplomatike në krijimin e shtetit shqiptar. Serbia nuk ishte e gatshme të respektonte kufijtë e Shqipërisë dhe as të njihte të drejta e shqiptareve të Kosovës dhe Maqedonisë të

cilat u vendosën me kompromis sipas propozimit të diplomacisë Austro-Hungareze. Gjatë krizës me Malin e Zi, Austro-Hungarisë ju desh që të mbliidhte Këshillin e Ministrave dhe të shpallte mobilizimin e ushtrisë për luftë ndaj Malit të Zi me qëllim që car Nikolla të lëshonte Shkodrën. Ajo u detyrua që të përdorte të njëjtën taktik si me Malin e Zi dhe për këtë i çoi një ultimatum prej 8 ditësh Serbisë. Ky ishte ultimatum i parë që Monarkia i çonte Serbisë dhe ishte tepër serioz pasi ultimatumi dytë pas disa muajsh çoi botën në Luftën e Parë Botërore. Si ultimatum i parë dhe i dytë u përgatitën nga ministri i Punëve të Jashtme i Austro-Hungarisë kont Berchtold. Nëse Serbia nuk do të kishte zbatuar afatin prej 8 ditësh të vendosur nga Monarkia e Danubit për të tërhequr trupat nga Shqipëria lufta botërore mund të kishte shpërthyer në vjeshtë të 1913. Po si arriti puna deri tek ultimatumit?

Vjena kishte kërkuar që trupat Serbe të largoheshin nga territori i shtetit shqiptar por Nikolla Pashiq injoronte vazhdimisht kërkesat e saj. Serbia nuk ishte e kënaqur që në 1878 dhe 1913 i kishte shkëputur shqiptarëve të gjithë vilajetin e Kosovës që ishte në mbi 32 mijë km², si dhe pjesë nga vilajetet e Maqedonisë dhe pjesën shqiptare të Sanxhakut. Ajo dëshironte akoma territore të shqiptarëve mundësisht të dilte në Adriatik me gjithë se Fuqitë e Mëdha me insistimin e diplomacisë Austro-Hungareze ja ndaluan asaj që në 1912 daljen në det.

Austro-Hungaria i kërkoi Konferencës së Ambasadorëve që në 30 prill të 1913 që “Serbisë t’i kujtohet me insistim obligimi i saj për të zbratur territorin shqiptar dhe për te respektuar vijat kufitare të Shqipërisë së V dhe V-L pikërisht ashtu siç janë caktuar prej Fuqive të Mëdha dhe si janë komunikuar qeverisë serbe më 15 prill”¹ Berchtold i kërkon ndihmë Italisë që “të deklarojnë në Beograd kategorikisht se një të drejtë të Serbisë për të okupuar pozitat strategjike mund ta pranoni vetëm jashtë dhe jo brenda kufijve të Shqipërisë që janë caktuar prej Konferencës së Ambasadorëve në Londër” si dhe “konferenca të shpërndahej vetëm atëherë kur në Beograd qe përsëritur demarshi në lidhje me zbrazjen e Shqipërisë”² Kërkesat e Vjenës duke parë

1 Telegram i Berchtold për ministrant e Jashtëm të Fuqive të Mëdha. 30 korrik 1913, Nr. 8114, tek Politika e Jashtme e Austro-Hungarisë në vitet 1908-1914, A. 41-42, f. 186. Hause und Hof Staats Archive, Wien, Politisches Archiv, që gjendet në Arkivin e Institutit të Historisë në Shqipëri. (HHStA, PA, IHSh).

2 Tel i Berchtold për Romë, Beograd, Londer, 26 korrik 1913, nr. 8055; Politika e

problematikën e ngjeshur në lidhje me statusin e shtetit shqiptar nuk patën kohë të trajtoheshin pasi Eduard Grey kërkonte të shpërndante konferencën sa më parë të jetë e mundur. Konferenca u shpërnda në gusht, pa e detyruar Serbinë të tërhiqte trupat nga tokat e Shqipërisë politike.

Gjatë shtatorit Vjena bëri përsëri orvatej që kancelarit perëndimore të mblidheshin serish për t'i kërkuar Beogradit që të zbraste tokat shqiptare përtej kufirit të caktuar nga Londra³ Në shtator filloj një luftë e shqiptareve ndaj trupave serbe dhe pas kësaj filloj edhe persekutim masiv serbe ndaj tyre. "Serbia justifikonte Vjenës këtë me pretekstin se shqiptaret përtej kufirit po përgatiteshin që të hidhnin në kryengritje popullsinë shqiptare matanë kufirit në tokë serbe"⁴ Shajnoviq përfaqësuesi i qeverisë Serbe në takim me ambasadorin e Monarkisë në Beograd i shprehet atij se "agjentët austriak duhet te kenë nxitur shqiptaret për kryengritje" ... "koincidenca e çuditshme e shpërthimit të kryengritje në momentin e urdhrin për zbrazjen e Shqipërisë duhet ta ketë detyruar opinionin publik në këtë besim se vetëm influenza e huaj mund të kishte detyruar malësoret deri tash paqësore që të fillojnë kryengritjen". Ndërsa për ambasadorin e Monarkisë Storck "qeveria serbe shqiptaret i njihte po aq mirë sa edhe ai dhe duhet ta ketë tashme të qartë se ky popull trim nuk do të duronte për një kohë të gjatë që territorin i qe siguruar prej Fuqive të Mëdha të mbahej nën pushtimin e trupave të huaja."⁵

As Fuqitë e Antantës dhe as Italia nuk po e përkrahnin Vjenën sepse e shikonin si zonë të influencës austriake. Rusia ishte e mendimit që "qëndrimi serb deri sot nuk ka dhënë shkaqe të mjaftueshme për të bërë një demonstracion në Beograd....Se një demstracion i tillë do të bënte efekte krejt të kundërta....Serbët për të ruajtur truallin e tyre mund të okupojnë edhe pika strategjike matanë kufirit sigurisht vetëm përkohësisht dhe për aq kohë sa ekzistonte rreziku... pas asaj qe ndoli

jashtme.... f. 183; HHStA. PA. IHS. .

3 Telegram i Berchtol, datë 4.9.1913, Nr. 8542,8596; Arben Puto; *Pavarsia shqiptare ne tryezat e diplomacisë*, Tiranë 2008, f. 188.

4 Note e legates Serbe ne Vjen datë 23.9.1913, nr. 8679; A. Puto, *Pavarsia...* vep. cit., f. 189.

5 Raport i Storck nga Bogradi 25. 09. 1913, nr. 8707, Politika e jashtme...., f. 235; HHSTA. PA. IHS.

duket e drejtë që Serbisë t'i jepet ndonjë kompensim qoftë i natyrës territoriale ose i një natyre tjetër". Ndërsa për Monarkinë "çështja e kompensimit është krejtësisht e padiskutueshme.. për sa i përket sulmit të shtetit shqiptar këtu nuk mund te flitet për të sepse shteti në formën që u parashikua prej fuqive të mbledhura në Londër nuk është krijuar ende. Nuk ekziston as princi dhe as xhandarmeria. Dëshira e sinqertë e qeverisë provizore për të shuar konfliktin tregon se këtu nuk është fjala për një sulm të shtetit por vetëm për një sulm të pa rëndësishme të popullsisë së dëshpëruar në kufi."⁶ Rusia nuk deshi të aprovoj nevojën e një demarshi sepse trupat serbe ndodheshin akoma në territoret e okupuara vetëm për arsyen se aty nuk ekziston asnjë organ i rendit publik dhe për këtë shkak mbas tërheqjes së trupave serbe do të qe frika për trazira".⁷

Serbia e përkrahur nga Rusia kundërshtonte hapur kërkesën e Austro-Hungarisë. Në 14 shtator Z. Spalajkovic ministri i Jashtëm i qeverisë Serbe në bisedë me Storck përfaqësuesin e monarkisë në Beograd i thotë këtij të fundit se "demarshi i projektuar për zbrazjen e Shqipërisë burimin e vet e paska vetëm në iniciativën tuaj" Ai shpresonte që Monarkia "të hiqte dorë prej qëndrimit armiqësor." Sipas tij "në Monarki ka me miliona serb por ju merreni me mikpritjen e shqiptareve kundrejt vëllezërve të këtij kombi me shumë kulture(serbët dhe përsa i përket zbrazjes "ai shpresonte se Storck do të bindte qeverinë e Austro-Hungarisë se Serbia trupat e veta nuk do t'i tërheq deri para se në Shqipëri të vendoset rregulli dhe të ekzistonte një xhandarmeri." Storck mendon se "demonstratat greke kundra Monarkisë për shkak të kufijve të Shqipërisë se Jugut i dhanë z. Spalajkovic kurajo të shprehet në një mënyrë aspak diplomatike".⁸ Pra përgjigja e Serbisë ishte vazhdimi i ofensivës edhe më thellë dhe mos tërheqja e trupave.

Berchtold menjëherë po atë ditë pas përgjigjes së qeverisë Serbe thirri përfaqësuesin e Serbisë në Vjene për t'i njoftuar se "kërkonte prej qeverise serbe një përgjigje të prerë lidhur me vendimet e Londrës për

6 Telegram i Otto Szernin prej Peterburgu, 3.09. 1913, nr.8763; Politika e jashtme..., f.244; HHStA, PA, IHSht.

7 Telegram i Thurn prej Peterburgut, datë 8 .09.1913, Nr. 8564, Politika...f. 218; HHStA, PA IHSht.

8 Raport i Storck nga Beogradi, datë 13 .09. 1913; nr. 8618; Politika e jashtme...; si dhe tek vj. 222-223; HHStA, PA, Albania IHSht.

kufijtë dhe rrjedhimisht tërheqjen e menjëhershëm të trupave serbe nga territori i Shqipërisë autonome. Beogradi nuk duhej të harroj rreziqet të cilave do t' u ekspozohesh në rast se nuk do t' i jepte satisfaksion të plotë kësaj kërkesë”.⁹

Storck mendon se “një hap unanim me të vërtetë i përshtatshëm dhe serioz i Fuqive të Mëdha, mund sillte Serbinë në vete, prapë se prapë akoma nuk guxoj të pretendoj se çështja e kufijve të Drinit ndodhet qysh tash në tryezën e bisedimeve dhe për të detyruar Fuqitë e Mëdha të respektojnë vendimet e tyre, do të jetë nevoja që ne të shkrijmë krejt energjitë tona. Vetëm për të detyruar Malin e Zi të hiqte dorë prej Shkodre u nevojiti një kërcënim lufte dhe një bllokadë efektive. Prandaj me duket tepër e dyshimet që Serbia të zbraz pikat strategjike që ajo mban të okupuara qysh prej krijimit të Shqipërisë”.¹⁰

Në një raport të atasheut ushtarak Austro-Hungarez në 24 shtator nga Beogradi tregohet se.. synohet një operacion ofensive në tokën shqiptare në titullin e një ekspedite hakmarrje dhe ndëshkimi. Koloneli Stefanoviq shpesh herë theksoj se sulmi i shqiptareve do të goditej aq keq sa që për shumë vjet me radhe atyre do t' u neveritej çdo ndërmarrje e tillë. Sipas eksperiencave të deritanishme mbi mënyrën e luftimit të serbeve sidomos kundër shqiptareve parashikohet një luftë e përgjakshme rrënimi dhe shkatërrimi me krejt barbarizmin dhe llahtarit e luftës së fundit ballkanike.....siç shkruan gazeta qeveritare ... “ata për krimet e tyre do të ndëshkohen ashtu siç e meritojnë si kriminel”... ”Koloneli Stefanoviq përmendi gjithashtu se për humbjet dhe për shpenzimet e fushatës së tashme Serbia do të kërkonte dëmshpërblim. Natyrisht këto do konsistonin në kompensim territorial”. Ai mendon se ”duke pasur parasysh këto ngjarje Konferencës së Londrës t' i bëhej revizionim rigoroz dhe kjo edhe ca me tepër kur vet krijuesit e Shqipërisë autonome sot duhet të pranojnë se kjo ide nuk qe me vend se parimi i kombësisë nuk mund të shkoj aq larg sa që në kurrizin e tij të pësojnë dëme edhe shtete të tjera”.¹¹ Pra, Serbia jo vetëm që hynte në tokat e shtetit shqiptarë dhe vriste popullsinë e pafajshme por kërkonte edhe

9 Bulletin mbi një bashkëfjalim me ambasadorin Serb datë 14.09.1913, nr. 8829; A. Puto, Pavarsia...f. 192.

10 Raport i Storck nga Beogradi, 24.09. 1913, OUA, 8692, Politika e jashtme..., f. 232-233; HHStA, PA, IHS

11 Raporti i atasheut ushtarak Austro-Hungarez nga Beogradi, datë 24 .09. 1913; nr. 8694, Politika...f. 233; HHStA, PA, IHS.

dëmshpërblim dhe ky të ishte territorial, pra me tokat të tjera shqiptare. Berchtold menjëherë sapo mori informacion mbi qëllimet e Serbisë ju nisi një telegram shefave të diplomacive në kryeqytete e Fuqive të Mëdha për t'i njoftuar ata se “masat ushtarake serbe po marrin dimensione aq të rëndësishme sa që mund të shpjegohen vetëm prej qëllimit të një aksioni më të madh kundër Shqipërisë autonome. Prej njoftimeve që na kanë ardhur prej konsujve përfundojmë se kryengritja shqiptare burimin e vet e ka në territoret që i janë atribuar Serbisë dhe se lëvizja u provokua prej brutalitetit të autoriteteve serbe.... Nën këto rrethana, jam i mendimit që nëpërmjet një demarshi të Austro-Hungarisë dhe Italisë në Beograd qeveria serbe të detyrohej që në lidhje me kufijtë dhe neutralitetin e Shqipërisë autonome si dhe për lënien e lirë të pazareve për kufitarët shqiptar, të respektoheshin vendimet e Londrës”.¹²

Fuqitë e Mëdha ende nuk ishin të vendosura të përkrahnin Austro-Hungarinë e cila dilte me tezën që Serbia po sfidon vendimet e gjithë Fuqive të Mëdha. Serbia i sfidonte pasi një pjesë e këtyre Fuqive e përkrahnin në veprimet e saj. “ Kolegu im Anglez – informon Storck nga Beogradi pretendon se ne rast se në Shqipëri do të rrinin kontingjente më të mëdha serbe atëherë do të qe shumë e vështire që Serbia të zbrazte pozitat e saj që ka okupuar në Shqipëri. Për këtë arsye pas pak javësh do të ndodheshim përpara alternativës që për shkak të autonomisë së Shqipërisë ose të ndërlikoheshin me një luftë ose t'i përkuleshim Serbisë... Sigurisht për të ruajtur vendimet e ambasadoreve që qenë adaptuar nën agjendën e saj, Anglia do të përkrahte sa qe e mundur , por në rast se për shakë të Shqipërisë do të shpërthente një luftë botërore, atëherë ai nuk beson se Evropa do të shkonte krah për krah me ne. Ambasadori gjerman këtë opinion pesimist nuk e pranon dhe beson në një përkulje të Serbisë”.¹³ Ndërsa Parisi “përgjegjësinë për gjendjen në territorin kufitar shqiptaro-serbe deri në një fare grade ja hedh Austrisë”.¹⁴

Ambasadori i Monarkisë në Beograd Storck pas një bisede me ambasadorin anglez atje mëson nga ai se “grekerit sipas shenjave

12 Tel i Berchtold për në Rome, Berlin, Londër, Paris, Perterburg, 24.09. 1913,nr. 8696, Politika, f. 233; HHStA, PA, A ISh.

13 Tel i Storck nga Beogradi, 24 shtator 1913; nr. 8691; Politika.... f. 232; HHStA, PA, ISh.

14 Tel i Josef Somssich prej Parisi, 25. 09. 1913, nr. 8711, Politika..f.237 HHStA, PA, ISh.

qenkan në harmoni të plotë me Serbinë dhe shpresojnë se Gjermania në Shqipëri nuk do të na përkrahte neve. Për këtë arsye për Serbinë situatë qenka e favorshme, prandaj krejt vështrimi i qenkan drejtuar Vjenës nëse aty mund të bëheshin akoma koncesione...Ai mendon se për të evituar komplikacione të renda evropiane nuk do të mbetet gjë tjetër”¹⁵ Serbia “ nuk priste ndonjë protestë të Fuqive të Mëdha për shakë të Shqipërisë sepse veprimi serb ka gjetur aprovimin e plotë të Rusisë”.¹⁶

Berchtold ju kërkon edhe një herë aleatëve të Tripalëshit Italisë dhe Gjermanisë që “qeveria e Beogradit pa humbur kohë të paralajmërohet për pasojat që do të sillte në vetvete shkelja e vendimeve të Londrës ... Ai i lajmëron aleatet mbi iniciativën e tij ”për të ngarkuar të ngarkuarin Austro-Hungarez në Beograd për të bërë në lidhje me këtë një demarsh miqësor por energjik pranë qeverisë së atjeshme”.¹⁷

Pasi lajmëron aleatët Berchtold i nis demarshin Serbisë por këshillon ambasadorin Storck që “ demarshin ta kryeni pa humbur kohë sapo që kolegu Italian të jetë në posedim të urdhrat të tij përkatës nga qeveria e vet. Në rast se ky urdhër nuk do të jetë e shumta deri të mërkurën atëherë hapin në fjalë do ta ndërmerri i vetëm. Në këtë rast do të përdorin një ton miqësor por qeverisë mbretërore serbe në mënyre kategorike do t’i lini të kuptoj pasojat serioze që detyrimisht do të priteshin prej një aksioni eventual ndaj Shqipërisë dhe kjo mund të evitohej nëpërmjet respektimit të vendimeve të Fuqive të Mëdha”¹⁸ Në 29 shtator Berchtold ishte në një gjendje agresive mendore. Ai dëshironte që të pushtonte qytetin verior të Serbisë Sabac dhe atëherë “u themi serbeve për sa kohë do të qëndroni në Shqipëri ne do të qëndrojmë në Sabac.”¹⁹ Conrad shefi shtabit të përgjithshëm të ushtrisë argumentoi se nëse monarkia do të pushtonte Sabac. Serbët ose do qeshnin me ne ose do të na luftonin, e para do të ishte një goditje serioze për prestigjin e

15 Tel i Storck nga Beogradi, 27. 09. 1913, nr. 8721, Politika....f. 238; HHStA, PA., IHSh.

16 Tel i Storck për Berchtold, 27. 09. 1913, nr. 8723, Politika..., f. 238; HHStA, PA., IHSh.

17 Tel i Berchtold për Romë e Gjermani, 27. 09.1913;nr. 8727, Politika... f. 239; HHStA, PA., IHSh.

18 Tel i Berchtold për Storck 29. 09. 1913, nr. 8743, Politika....., f. 241; HHStA, PA., IHSh.

19 Conrad Feldmarschall; Aus meiner Dienstzeit; Vienn, Rikola Verlag 1921; f. 443-444.

monarkisë dhe e dyta do të thotë luftë. Conrad favorizonte të dytin nëse serbët nuk i përgjigjeshin një ultimatumit 24 orësh.

Pas u përgatit demarshi Berchtold e udhëzoi përfaqësuesin e Monarkisë në Serbi Storck “të paralajmëronte Beogradin se ishte i detyruar të respektonte vendimet e Konferencës së Londrës sepse ndryshe do të përballej me pasoja shumë serioze”.²⁰

Në një takim me Spalajkoviq ministrin e Jashtëm të Serbisë ambasadori Storck i paraqet atij demarshin e Austro-Hungarisë. Në demarsh thuhej se “Qeveria perandorake dhe mbretërore e Austro-Hungarisë tërheq vëmendjen qeverisë serbe mbi pasojat tepër serioze të një aksioni ushtarak kundra Shqipërisë aksion ky që do të që në kundërshtim me vendimet e Londrës. Qeveria mbretërore mund t’i evitonte këto konsekuenca duke respektuar në mënyrën me rigorozë vendimet e Londrës”²¹ Storck i thotë ministrit të Jashtëm Serb se “në Shqipëri dëshirojmë vetëm paqen, qetësin dhe rregullin do të që çmenduri që ne dhe agjentet tanë të pretenduar të akuzoheshim se paskemi nxitur popullsinë shqiptare kundra Serbisë”.²²

Pasi u morr vesh se Austro-Hungaria i dërgoi demarsh Serbisë diplomacitë e Fuqive të Mëdha vihen në lëvizje që t’i mbushin mendjen Serbisë që Vjena e kishte seriozisht. Ambasadori Gjerman në Serbi i tërhoqi vërejtje Spalajkoviq në emër të qeverisë së tij se “nuk duhej bërë asnjë avancim ose ndjekje në kufirin e Shqipërisë autonome. Nuk duhej bërë sepse Fuqitë e Mëdha janë në favor të respektimit të vendimeve të Londrës.”²³ Zëvendës ministri i Jashtëm i Rusisë Neratow informon ambasadorin e Monarkisë atje “se ditët e fundit ai e kishte këshilluar në mënyrën më energjike të ngarkuarin me punë të Serbisë “se qeveria serbe duhej të ruhej prej çdo politike aventureske dhe duhej të kufizohej në mbrojtjen më rigorozë... atij ju duk e drejt që për sakrificat e fundit Serbisë t’i jepej ndonjë kompensim në formën e revizionimit të kufijve karshi Shqipërisë.”²⁴

20 Tel i Berchtold për Storck në Beograd datë, 29. 9. 1913, nr. 8743; A. Puto; f. 190.

21 Tel i Storck prej Beogradi 1. 10. 1913, nr. 8766; Politika....f. 245-246; HHStA, PA., IHS.

22 Tel i Storck për Berchtold, 1. 10 1. 1913, nr. 8765, Politika.... f. 245; HHStA, PA. A, IHS.

23 Tel i Storck për Berchtoldit, 29 .09. 1913, nr. 8745, Politika... f. 241; HHStA, PA. A, IHS.

24 Tel i keshilltarit të legates A-H Otto Szernin prej Peterburgu, 30. 09. 1913, nr.

Në fillim të tetorit Nikolla Pasichin kaloi transit në Vjen pasi kishte pasur takime në Parisë. Ai deklaroi për shtypin në Vjenë që “unë dua t’u siguroj ju, se ne nuk kemi ndërmend të zgjerojmë kufjet e ndarë midis nesh dhe Shqipërisë. Ne do të biem dakord me këtë problem duke mbajtur një kufi strategjik korrekt midis nesh dhe principatës së ardhshme Shqiptare në negociata midis nesh dhe një Komisioni Ndërkombëtar të zgjedhur nga Fuqitë e Mëdha.²⁵ Ndërsa gazeta “Samauprava” idenë e vizitës së Pasiq në Vjenë e quan “një ofendim të kujtimit të serbëve që tash po vriten prej plumbave austriak në Shqipëri.²⁶

Më 3 tetor në një konferencë ndërministrare të gjithë ministrat e Monarkisë ishin në favor të një aksioni energjik kundra Serbisë. Berchtold paraqet dy alternativa në lidhje me konfliktin shqiptaro-serbe, “ose të tolerojmë në heshtje një fakt të kryer që do të formonte fazën e parë dhe sigurisht të fundit të përpirjes së Shqipërisë’ nga ana e serbeve ose ti drejtojmë Beogradit një ultimatum në lidhje me zbrazjen e Shqipërisë autonom prej trupave serbe. Krijimin e Shqipërisë së pavarur e kemi konsideruar gjithnjë si punë tepër të vështir diplomatike por edhe si mjetin e vetëm për të ruajtur ekuilibrin në Adriatik. Mbase neve këtë pikësynim deshëm ta bënim me mjete paqësore prandaj neve na u desh të vinim në marrëveshje me fuqitë e tjera, shteti shqiptar me anën e kompromiseve u zvogëlua ne minimumin e vitalitetit të tij. Në këto rrethana duket e pamundur që Serbisë t’i bëhen koncesione të tjera. Kjo jo vetëm do të dëmtonte rënd prestigjin tonë por edhe të ardhmen e Shqipërisë do ta bënte akoma më të vështir sesa është sot... në të ardhmen ne nuk do të kemi të bëjmë me një Turqi të drobitur dhe me shtete të dobët dhe të vogla në Ballkan, por me shtete ushtarake të forta dhe të bashkuara prej të cilave dy kufitaret tanë, rrënjët etnike të të cilave janë përhapur thellë në monarkinë tonë, dhe që ushqejnë aspiratat mbi territore respektive, ndërsa ekzistenca e shtetit shqiptar që u krijua prej nesh dhe Italisë gjithashtu duket e kërcënuar prej dy prej shteteve ballkanike”. Kryeministri Hungarez konti Tisza tha se ne nuk duhet të tolerojmë asnjë modifikim të kufijve të Shqipërisë që

8762, Politika..., f. 243; HHStA, PA, IHS.

25 Richard Cooper Hall, Austro-hungary and northern Albanian frontiers, 1912-1913; Ohio State University 1974, f. 102.

26 Raport i Storck nga Bogradi 25. 09. 1913, nr. 8707, Politika....., f. 235; HHStA, PA. A. IHS.

u caktuan në Londër...se neve në lidhje me zbatimin e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të veprojmë edhe vetëm... dhe se në rast se një protestë energjike nuk do të ndihmonte atëherë duhej dhënë një ultimatum për t'i shkaktuar Serbisë një disfatë diplomatike ndoshta edhe një ushtarake. Këtu nuk duhej hezituuar dhe vonuar"²⁷ Për Count Tisza...“situata në kufirin Serbi-Shqipëri na jep neve të zgjedhim nëse ne duam të jemi një fuqi viable apo duhet të pranojmë një rënie poshtëruese. Me timiditetin e përditshëm në humbëm perspektiven tonë. Unë të kërkoj ty (Berchtoldit)që të japësh deklaratën kategorike në Beograd si dhe në Berlin dhe Romë që ne nuk do të lejojmë një shkelje në kufijtë shqiptar të vendosura në Londër dhe ne nuk mund të lëmë veten tonë që të vonohemi në mbrojtjen e interesave tona nga që jemi të lidhur me Koncertin Evropian.²⁸ Por, Franc Ferdiand ishte kundra një lufte me Serbinë pasi ai donte të rregullonte disa probleme të brendshme para se të hynte në luftë me të. Kjo e la Berchtoldin pa mbështetje dhe po merrte në konsideratë edhe dorëheqjen.²⁹

Më 7 tetor Berchtold shumë i duruar i dërgon edhe një herë tjetër Storck-ut një porosi për Pashich. Berchtold i kërkon atij që “ të paralajmëroj kryeministrin (Nikolla Paschic) që të heq dorë prej kalimit të këtyre kufijve nga ana e trupave serbe dhe të vëri në dukje pasojat serioze që mund të sillte në vetvete ky kalim”.³⁰ Po atë ditë Berchtold njofton Berlinin “që trupat serbe në kundërshtim me sigurimet e dhëna prej qeverisë se Beogradit vazhdojnë të kapërcejnë kufijtë e Shqipërisë që u cakton në Londër dhe të okupojnë vendet që i janë atribuar principatës autonome. Mbasi ky veprim i Serbisë duket i përshtatshëm për të sjellë në vete konsekuenca shume serioze dhe të padiskutueshme, sipas mendimit tonë do të qe e këshillueshme që të përdorim mjetin e një demarshi të përbashkët, që secila prej Fuqive të Mëdha t'i hiqte Serbisë vërejtje mbi pasojat e veprimi të tillë dhe ta ftonë atë për të respektuar me rigorozitet vendimet e Londrës”.³¹

27 Protokoll i Këshillit të Ministrave, Vjen 3. 10. 1913, nr. 8779, Politika..., f. 247-249; HHStA, PA, IHS.

28 Hugo Hantsch; *Leopold Graf Berchtold Grandseigneur und Staatsmann*; Graz (1963) f. 498-99.

29 Hugo Hantsch; Po aty, f. 500.

30 Tel i Berchtold këshilltarit të legates Storck, 7. 10. 1913, nr. 8796; Politika...f. 250. HHStA, PA, IHS

31 Tel i Berchtold për në Berlin, datë 10. 10. 1913, nr. 8816, Politika ...f. 253, HH-

Berchtold në 14 tetor duke dashur ta zgjidh konfliktin në rrugë paqësore e udhëzon Storck që t'i thotë Pashiqit se...” jemi të detyruar që t'i bëjmë qeverisë Serbe pyetjen nëse ajo është e gatshme që të pezulloj përgatitjet ushtarake për një invadim të Shqipërisë brenda një afati të shkurtër dhe të tërheq trupat që tashmë ndodhen në tokën shqiptare? Prej një përgjigje të kësaj pyetje...monarkia duhet të varë qëndrimin e saj të mëtejshëm ndaj Serbisë, mbasi neve jemi të vendosur që të sigurojmë me çdo mjet që do të na dukej i përshtatshëm respektimin absolute të vendimeve të Londrës”.³² Kjo ishte nota e tretë që monarkia dualiste i dërgonte Serbisë dhe më e forta nga të terja.

Më 15 tetor Pashiq i kthen Storck një përgjigje sfiduese “se është në vullnetin e çdo kombi për të shprehur dëshira për përmirësimin e kufjeve të vet”.³³ Storck thotë se Serbia nuk do të përkulet kaq lehtë . . .për këtë do të që nevoja për një quasi ego unanime të Fuqive të Mëdha ndaj Serbisë... në rast se ne duhet të veprojmë vetëm atëherë realizimi i vullnetit tonë do të na kushtoj me shumë se gjithçka që kemi arritur deri sot kundrejt Serbisë. Pa ndonjë detyrim fizik ose pa ndonjë kërcënim ajo nuk do të nënshtrohet. Nëse punët do të shkonin kaq larg atëherë sigurisht Serbia do të përkulej menjëherë dhe do të kënaqej që i kishte shkaktuar monarkisë edhe njëherë shqetësime të renda dhe sakrifica material...Gazeta “Samuprava” nga ana tjetër në numrin e 15 tetorit shkruan që dëmet që ka pësuar Serbia nga shqiptarët duhet në fakt t'i paguanin krijuesit e Shqipërisë. Por duke qenë se kjo metodë nuk do të që e zbatueshme mbeteshin vetëm dy rrugë. “ose fqinjëve të kërcënuar nga agresoret shqiptar t'u jepeshin kufij të mirë ekonomik, gjeografik dhe strategjik dhe çka sigurisht i shërben nevojës kryesore të paqes në Ballkan. Ose Fuqitë e Mëdha të marrin angazhimin formal për dëmet që i janë shkaktuar dhe do të shkaktohen akoma prej agresionit të shqiptarëve”.³⁴

StA, PA, IHSh

32 Tel i Berchtold për Storck, datë 14. 10. 1913, nr. 8828; Politika...f., 255; HHStA, PA, IHSh.

33 Tel i Storck për Berchtold, datë 15 tetor 1913, nr. 8835, Politika... f. 256; HHStA, PA., IHSh.

34 Tel i Storck për Berchtold i datës 15. 11. 1913, nr. 8836; Politika... f. 257; HHStA, PA., IHSh.

Po në 15 tetor Berchtold në një telegram për në kryeqytet e Tripaleshit u shpjegon atyre se Vjenës po i soset durimi me Serbinë. “Neve- thotë- Berchtold “nuk jemi në gjendje të tolerojmë edhe me tej me qetësi dhunimet serbe që kryhen në dëm të Shqipërisë autonome por nëpërmjet demarshit tonë ne dëshirojmë që t’i japim Serbisë edhe një rast që të heq dorë me vullnetin e saj prej këtyre dhunimeve dhe shpresojmë se kabineti këtë do ta vendos në mënyrë spontane. Ne rast se nuk do të ngjis ndonjë gjë e tillë atëherë natyrisht do të qemë të detyruar që në Beograd të ndërmarrim hapa edhe më kategorike”.³⁵

Në 16 tetor Storck njofton se “Pashiq kishte llototitur dje për një plebishit të popullsisë shqiptare në Shqipërinë autonome që tash është okupuar prej Serbisë një vox populi e cila gjoja se do të jepte për rezultat se vet popullsia kufitare e dëshiroka aneksimin serbe” Storck është i mendimit se “qytete thjesht shqiptare si Gjakova dhe Dibra e të tjerë nuk qenë caktuar kurrë që t’i merrte Serbia. Ne rast se kjo për shkak rrethanash të ndryshme u bë atëherë Serbia duhet të ishte shumë e kënaqur. Sidoqoftë ky vendim i disfatorshëm për Shqipërinë autonome nga Fuqitë e Mëdha nuk do të qe shkak për t’i marr Shqipërisë territore të tjera... neve gjykon Storck duhet të mbrojmë kauzën shqiptare duke u hedhur ne sulm”.³⁶ Ndërkohë “Serbia, Greqia dhe, Mali i Zi mendojnë seriozisht në okupimin e krejt Shqipërisë dhe duan të krijojnë një fakt të kryer dhe të papritur. Në lidhje me këtë janë përhapur zëra se në Serbi është projektuar mobilizimi i krejt thirrjes së dyte nën armë dhe se për përgatitjet po punohet gjithnjë edhe me intensitet të madh”.³⁷

« Në 16 tetor në Vjen u vendos që t’i dërgohej Serbisë një ultimatum. Perandori dhe trashëgimtari kishin frikë se mos një konflikt me Serbinë do të ngrinte një Ligë Ballkanike kundër por Berchtold siguroi se Turqit do të kujdesesh për këtë mundësi ». ³⁸ Një ultimatum kishte bërë punë edhe ndaj Mali te Zi kështu që mendohej se kjo mund të tërhiqte Serbët jashtë nga Shqipëria. Por, nëse Serbia do të

35 Tel i Berchtold për Romë dhe Berlin, datë 15. 10. 1913, nr. 8837; Politika..., f. 257; HHSa, PA, IHSa.

36 Raport i Storck nga Beogradi, datë 16 .10.1913, nr. 8846; Politika... f. 258; HH-StA, PA, IHSa.

37 Tel i Storck prej Beogradi, datë 17 .10. 1913, nr 8852; Politika..., f. 260-261; HHStA, PA., IHSa.

38 H. Hantsch, vep. cit., f. 501.

përgjigjej negativisht atëherë Austria kishte vetëm një rrugë që të ruante prestigjin e saj që ishte, t'i shpallte luftë Serbisë dhe që mund të çonte në një luftë evropiane dhe një luftë botërore ose të hiqte dorë njëherë e përgjithmonë nga politika e saj ballkanike dhe nga statusi i Fuqisë së Madhe. Berchtold pyeti perandorin nëse ai e autorizonte t'i niste një ultimatum Beogradit".³⁹ Perandori ra dakord. Berchtold me stafin e tij ka ndenjur gjithë natën 16 për në 17 të shkruante ultimatumin. Në fakt "Conrado kishte kërkuar më parë pak kohë që të përgatiste trupat ushtarake".⁴⁰ Kjo pasi në rast se Serbia do t'i përgjigjej negativisht ultimatimit të Austro-Hungarisë, Monrakia nuk kishte rrugë tjetër nëse donte të ruante nderin e saj veçse të sulmonte Serbinë. Pasi u përfundua ultimatum i ju çua perandorit që ta miratonte. Perandori u shpreh... "nëse ata nuk japin dorëheqje në tetë ditë ne sigurisht që do të sulmojmë".⁴¹

Ultimatumi i Austro-Hungarisë ndaj Serbisë i 17 tetorit përmbante këtë notë për qeverinë e Beogradit: "Legata perandorake dhe mbretërore në Beograd pati nderin t'i heqë m shumë se një herë me urdhrin e qeverisë se vet vëmendjen ministrit mbretëror të Punëve të Jashtëm mbi nevojën e respektimit rigoroz të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe për të hequr dorë prej çdo aksioni ushtarak në territoret që me vullnetin e Fuqive të Mëdha ju atribuon Shqipërisë. Nga pikëpamja e qeverisë perandorake dhe mbretërore është edhe sa më sipër e justifikueshme kur Londra mori në konsideratë në një masë të gjerë dhe në dëmin e Shqipërisë dëshirat e formuluar nga ana e Serbisë. Austro-Hungaria në asnjë rast nuk mund të jap pëlqimin që vendimi ndërkombëtar për kufijtë e Shqipërisë të modifikohej në favor shumë të madh të Serbisë. Përgjigja e fundit që ju dha në lidhje me këtë prej qeverisë mbretërore serbe legatës perandorake dhe mbretërore është po aq e pakënaqshme sa edhe përmbajtja e shërbimit që ju dorëzua ministrit perandorak dhe mbretëror të Ministrisë së Jashtme prej ministrit serb. Në fakt urdhri që ju është dhënë trupave serbe për të pezulluar marshimin nuk mund të konsiderohet i kënaqshëm. Në sytë e qeverisë perandorake dhe mbretërore është e domosdoshme që qeverisa serbe të procedojë pa vonesa në tërheqjen e trupave që kanë

39 Po aty, f. 502.

40 Conrad, vep. cit., f. 466.

41 H. Hantsch, vep. cit., f. 502.

kaluar kufijtë që janë caktuar Shqipërisë sipas Konferencës së Londrës dhe që për pasoj okupojnë territore që bëjnë pjesë në Shqipëri. Qeverisë perandorake dhe mbretërore i pëlqen të shpresoj se qeveria serbe nuk do të vonoj për të proceduar në zbrazjen integrale të territoreve brenda një afati prej tetë ditëve... Në rast të kundërt qeveria perandorake dhe mbretërore me keqardhje më të thellë do ta shihte veten të detyruar që të përdore mjetet e përshtatshme për të realizuar kërkesën e saj”.⁴² Ky ultimatum u dërgua ambasadorit në Beograd i cili ja paraqiti qeverisë serbe më 18 tetor në mesditë. Ultimatumi u prit mirë nga opinioni publik. Gazeta “Neue Freie Press” shkroi se .. Loja e Shkodrës nuk do të përsëritet dhe periudha e tetë ditëve tregon se monarkia do të zgjidh këtë problem shpejt. Serbia do të tërhoqi trupat.⁴³

Po më 17 tetor Berchtold u nisi një telegram të gjitha Fuqive të mëdha ku ndër të tjerash u thotë se. “qysh prej fillimit të armiqësive midis shteteve ballanike dhe Turqisë , Austro-Hungaria fuqi e afërt e Ballkanit ka mbajtur një qëndrim paqësor. Duke abstenuar prej çdo ndërhyrje në ngjarjet luftarake dhe prej çdo aspiratë me përfitim tokësor, ajo kufizohet të bashkëpunoj me Fuqitë e Mëdha me rivendosjen e paqes dhe përsa i përket Adriatikut në krijimin e një shteti shqiptar. Duke pasur parasysh këtë qëllim Austro-Hungaria vendosi të marr pjesë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër ku çështja shqiptare duhej diskutuar me problemet e tjera që i qenë rezervuar verdiktiti të Fuqive të Mëdha. Është e qartë se për t’u përgjigjur qëllimeve të Austro-Hungarisë dhe të kabineteve të tjera çështja shqiptare duhej zgjidhur në mënyrën që shteti i ri të ishte i aftë për ekzistencë. Për këtë arsye qe një nevojë imperative qe e pakta territoret thjesht shqiptare të përshiheshin brenda kufijve të saj. Nëse Austro-Hungaria dha pëlqimin për të bërë në këtë pikë koncesione shumë të rëndësishme sidomos duke pranuar që qytete esenciale shqiptare si Dibra dhe Gjakova t’i shkëputeshin Shqipërisë, kjo u bë vetëm e vetëm për të mos u veçuar prej Fuqive të Mëdha dhe për të siguruar një zgjidhje paqësore të problemit. Të gjitha këto koncesione të Serbisë nuk e penguan Serbinë të vonoj me muaj të tërë tërheqjen e trupave prej Shqipërisë. Bile edhe përballë demarsheve

42 Ultimatumi i Austro-Hungarisë ndaj Serbisë, datë 17 .10. 1913, nr. 8850; Politika..., f. 260; HHSIA, PA. IHSh

43 Neue. Freie.Presse, 19.10. 1913,nr.17657, f. 1. R. Copper Hall Austro-Hungary, vep. cit., f. 115.

të Fuqive të Mëdha Serbia ka refuzuar që të zbraze territoret në fjalë. Nga ana tjetër Serbia na ka lënë të dyshohet se nuk ka aspak ndërmend që zbrazen e Shqipërisë ta konsideroj si një masë definitive. Për këtë arsye qeveria serbe pretendon se kufijtë e Shqipërisë që u caktuan prej Konferencës së Ambasadorëve në Londër nga pikëpamja strategjike nuk janë të favorshëm. Ndërkaq, duhet nënvizuar pikërisht se për të kënaqur eksigjencat serbe Fuqitë e Mëdha adaptuan kufijtë e tanishëm që lënë jashtë Shqipërisë qytete dhe territore që nga pikëpamja gjeografike dhe etnografike duhet të bënin pjesë në të.. kabineti i Vjenës nuk ka hesitur që të jap në Beograd këshilla urtie.. për më tepër Serbia vazhdon të jetë kokëfortë përkundrejt vendimeve që u morën në Londër prej Evropës, mbarë qeveria mbretërore dhe perandorake e shikon veten të detyruar që të marr në duart e veta ruajtjen e interesave të paqes. Legata perandorake dhe mbretërore e Beogradit mori për pasoj një urdhër për t'i dorëzuar qeverisë mbretërore Serbe një notë.⁴⁴

Nga fuqitë e Tripalëshit Gjermania ishte përkrahja më e fortë e Monarkisë në lidhje me Serbinë. “Kaiseri Gjerman vërejti se për të është një kënaqësi e veçantë të dëgjoj qe neve jemi të vendosur për të mos u përkulur para Serbisë duke shtuar se në këtë çështje do të bashkëpunonte me ne”.⁴⁵ Kancelari i Reichi “demarshin tonë në Beograd e paska përkrahur me gjithë shpirt dhe në mënyrën më energjike dhe shpreson se Serbia do t’i bindej këshillave të Tripalëshit”.⁴⁶ Ndërsa Gjermania e aprovoi vendimin e Monarkisë, Italia nuk aprovoj metodën e ashpër të përdorur ndaj Serbisë. Markezi San Giuliano në lidhje me këtë vërejti se “metoda imperative që u përdor prej nesh në Serbi do të prodhonte dëshpërim të madh dhe do të dëmtonte interesat e Tripalëshit sidomos atë të Monarkisë”. Ambasadori monarkisë në Romë i ishte përgjigjur San Giulianit se “ndaj Serbisë ne kishim treguar një durim mbinjerëzor dhe se kur Italia ndërmori ekspeditën në Libi si neve dhe Gjermania nuk kishim dijeni që më përpara. Ai u përgjigj se veprimi Italian më 1911 nuk kishte pasur mundësi të krijoj casus foederi (rastin e beslidhjes)

44 Tel i Berchtold për në kancelarit e Fuqive të Mëdha, 17 .10 1913, nr. 8854; Politika..., f.261-262; HHStA, PA. IHSht.

45 Buletin i ambasadorit Austro-Hungarez në Berlin. 18. 10. 1913, nr. 8861; Politika..., f. 264; HHStA, PA. IHSht.

46 Tel i Joham Forgach prej Berlini, 19 tetor 1913, nr. 8873, Politika..., f. 268; HHStA, PA. IHSht.

i cili mund të vërtetohej tash dhe i cili do ta kish detyruar Italinë të plotësoj në mënyre legale angazhimet e veta”.⁴⁷ Italia e kundërshtonte me pretendimin se kjo mund të sillte konsekuenca edhe për Italinë nga që ishin të lidhura në aleancë me Monarkinë pasi nëse Austria do t’i shpallte luftë Serbisë atëherë sipas aleancës edhe Italia duhej të merrte pjesë në të, prandaj edhe ajo duhej pyetur më parë.

Pas ultimatumit Anglia ngarkoi ambasadorin e vet në Serbi që “të këshilloj qeverinë mbretërore serbe për të dhënë siguri se kufijtë që janë caktuar në Londër do të respektohen dhe se trupat serbe nuk i kanë kapërcyer ato veçse në vështrim të rrethanave të jashtëzakonshme dhe do të tërhiqen sa më parë të jetë e mundur”.⁴⁸

Ndërsa i dërguari Francës në Beograd e kishte vizituar ambasadorin e monarkisë atje dhe siç njofton Storck “ishte shumë i tronditur dhe më pyeti nëse në fakt do të që e vërtetë që për shkak të zbrazjes së Shqipërisë unë të kisha dorëzuar një notë me afat të caktuar.”. nuk ngurrova t’i konfirmoj thotë Storck “se Serbia brenda një afati prej tetë ditësh duhet të zbrazte Shqipërinë ose duhet të priste pasoja të pashmangshme. Se në çfarë do të konsistonin këto konsekuenca ai mund t’i përfytyronte edhe vet fare mirë. Vetëm mund të shtoja se për monarkinë në raste se ajo do të detyrohej që të mbaj gati për të tretën herë ushtrinë e saj dhe kështu të dëmtoj rendë materialisht, shpenzimet kësaj radhe do t’i ngarkohen Serbisë. Ambasadori i Francës pretendonte se afati prej 8 ditësh ishte i shkurtër.. ndërsa Storck iu përgjigje se serbeve për marshimin e tyre ju deshën katër ditë kështu që tetë ditë për tërheqjen janë mëse të mjaftueshme.. Sipas Storck “ai edhe kolegu Ruse kishin pas qenë ata që kishin penguar çdo realizim të një demarshi kolektiv serioz”.⁴⁹ “Berchtold aprovon gjuhën që kishte përdorur Storck me ambasadorin Francez ...”dhe sidomos vërejtjen se Serbia duhet të paguaj shpenzimet në rast se ajo do të na detyronte prapë për një mobilizim tjetër. Kjo përputhet plotësisht me qëllimet e qeverisë Austro-Hungareze, mbasi neve edhe sikur Serbia prej hezitimit të saj do

47 Tel i Ambrozy prej Rome, datë 20. 10. 1913, nr. 8888; Politika..., f. 272; HHStA, PA, IHS.

48 Tel i keshilltarit Storck nga Beogradi datë 19. 10. 1913, nr. 8868; Politika..., f. 266; HHStA, PA, IHS.

49 Tel i Storck nga Beogradi, datë 19. 10. 1913, nr. 8870; Politika..., f. 267; HHStA, PA, IHS.

të na ngarkonte vetëm me shpenzimet për masa të thjeshta përgatitore ushtarake do të qemë të detyruar të kërkojnë prej Serbisë shpenzimet për këtë”.⁵⁰

Për ambasadorin Serb në Vjenë “qeveria serbe qe tepër e habitur mbi faktin se ne me gjithë sigurimin e saj të prerë për të respektuar kufijtë e Shqipërisë që u caktuan në Londër paskemi gjetur të domosdoshme për të ndërmarr në Beograd një demarsh aq energjik dhe plotë presion...Në rast të okupimit të disa pikave strategjike në Shqipëri ajo e paska gjetur të nevojshme me qëllim për të marr prej Fuqive të Mëdha aprovimin për një ratifikim të vogël të kufijve i cili nuk do të qe vetëm në interesin e Serbisë por edhe në atë të Shqipërisë. Për të manifestuar ndiejna paqësore të saj kundrejt hapave tanë energjike qeveria serbe dje ju ka dhënë urdhër trupave tanë në Shqipëri për zbrazjen e pozitave të okupuara dhe për t’u tërhequr prapa kufijve të caktuar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Berchtold nga ana e tij i kërkon përfaqësuesit Serb në Vjenë “ se më duhet të ngul këmbë që zbrazja do të qe e plotë dhe duhet të marr fund para kalimit të afatit që është dhënë prej nesh. Veç kësaj padashur të dyshoj në sinqeritetin e qeverise serbe më duhet t’i rezervoj vetes të drejtën që zbatimi i vërtetë i kërkesës sonë të konstatohet në vend prej dëshmitarësh”.⁵¹

“Në 20 tetor qeveria Serbe me anën e Stefanoviq njoftoj se urdhri për zbrazje qe vendosur qysh dje dhe sot në mëngjes do t’ju dërgohej trupave. Zbrazja do të kryhej brenda tetë ditëve të afatit”.⁵² Stefanoviq shefi Shtabit të Ushtrisë serbe i ankohet ambasadorit Austriak “se afati që i qe akorduar Serbisë nga ana jonë ishte tepër i shkurtër” Ndërsa për Storck “ne rast se do të qe e vërtetë se siç kishin siguruar përherë në këtë ministri trupat serbe ndodheshin vetëm pak kilometra matanë kufirit, afati duhet të mjaftonte në mënyrën më të bollshme për t’u tërhequr prej kësaj largësie të vogël”.⁵³ Më datën 25 tetor Strock njofton nga

50 Tel i Berchtold për Storck, datë 20. 10. 1913, nr. 8877; Politika..., f. 269; HHStA, PA. IHS.

51 Buletin mbi visitën e ambasadorit serb në Vjenë, datë 20 .10. 1913, nr., 8878, Politika...f. 269; HHStA, PA. IHS.

52 Tel i Storck për Berchtold, 20. 10. 1913, nr. 8880, Politika..., f. 270; HHStA, PA. IHS.

53 Tel i Storck për Berchtold, 20. 10. 1913, nr. 8880, Politika..., f. 270; HHStA, PA. IHS.

Beogradi se “tërheqja e trupave serbe ka marr fund në mesditë, tash sa ma komunikoj me shkrim sekretari i përgjithshëm dhe mu lut që këtë t’ia komunikoj edhe qeverisë Austro-Hungareze”.⁵⁴ “Le të shpresojmë se Shqipëria e varfër dhe e torturuar, nesër të ketë një të diel të lumtur të parën mbas ndjekjes të përgjakshme, rrënimesh, vrasjesh dhe grabitjesh që zgjaten për javë të tëra.. Le të shpresoj gjithashtu se edhe djemtë e djemve të shqiptareve të sotëm këtë ditë feste do ta kujtojnë me gëzim dhe do të mbajnë në kujtesën e tyre se kujt ja detyrojnë ata jetën e tyre”.⁵⁵

Ultimatumi Austro-Hungarez la një shije të hidhur tek disa fuqi të mëdha. Ambasadori Anglez në Vjen ju shpreh Berchtold –it se “Ai nuk mund të aprovonte plotësisht modu precedentin që qe zgjedh prej nesh. Sipas mendimit të tij neve duhet të vepronim në marrëveshje të mëparshme së bashku me fuqitë e tjera të mbledhura kështu që ashpërsia e kërkesës drejtuar Serbisë do të qe zbutur në mënyrë të konsiderueshme”.⁵⁶ Në fakt Austro-Hungaria ju lut me muaj të tërë Fuqive të Mëdha dhe ato nuk pranuan të ndërmerrnin një demarsh së bashku, kështu që ajo u detyrua të vepronte e vetme.

Ndërsa Sazanov në takim me nënsekretarin gjerman të shteti Zimmerman, është shprehur se, “Në Serbi paska ngelur prapa një ndjenjë dëshpërimi kundra Austro-Hungarisë që përfshin në vetvete rreziqe për të ardhmen. Zoti Zimmerman i është përgjigjur se” Ne rast se Austro-Hungaria ka vepruar e vetme atëherë kjo i detyrohet faktit se sipas eksperiencave të deritanishme demarshet ndërkombëtare shkojnë shumë ngadalë dhe nuk janë aq të efektshëm. por në këtë rast një përfundim sa me i shpejt i gjendje se pasigurisë qe në interesin e krejt Fuqive të Mëdha. Zhvillimi i krizës i paska dhënë të drejtë taktikës Austro-Hungareze”.⁵⁷

54 Storck nga Beogradi 25 .10. 1913, nr. 8919, Politika ..., f. 279; HHSTA, PA, IHS.

55 Storck nga Beogradi 25 .10. 1913, nr. 8919, Politika..., f. 279; HHSTA, PA, IHS.

56 Buletin mbi vizitën e ambasadorit Anglez në Vjen, 20. 10. 1913, nr. 8884, Politika..., f. 271; HHStA, PA, IHS.

57 Buletin mbi vizitën e të ngarkuarit me punë të Gjermanisë 24.10. 1913, nr. 8906 Politika..., f. 276-277; HHStA, PA., IHS.

Ma. Elena KOCAQI

SUMMARY

AUSTRO-HUNGARIAN ULTIMATUM OF OCTOBER 1913 TO SERBIA FOR WITHDRAWAL OF ITS TROOPS OF ALBANIA

In October 1913, Austria-Hungary entered into conflict with Serbia as Serbian troops did not retreat from Albania, which political borders have been determined through difficult compromises by the Great Powers in London Conference of Ambassadors. The Monarchy was enforced to send an ultimatum to Serbia, demanding its withdrawal from Albania within eight days, or would pursue other means to realize its demands. As final means to be used by Austria-Hungary in case Serbia would repulse this ultimatum was the force. In order to defend its prestige Austria-Hungary was left with no other choice but to declare war on Serbia in case of negative reply. This war between two parties could be transformed into a European or eventually World War considering political-military alliances involvement of the Great Powers, which would automatically position them against each-other.

Serbia had the support of Russia and France in resisting implementation of the London conference decisions which determined its southern border in Drin River, while Serbian final goal was to exit to the Adriatic. This violated the geopolitical goals of the Danube Monarchy which linked its own existence with that of Albanian state. Austria viewed this state of Albania as the guarantee of balance in the Adriatic and Balkans setting limits to Serbia and Italy in their present positions. Serbia's exit into the Adriatic was the direct threat to the monarchy as Serbia aspired to get hold of territories of the empire at a time when it would eventually strengthened and supported by Russia, as it became reality afterwards. Also, the placement of Italy to the other side of the Albanian lands would have made Adriatic an Italian lake, and with Italian claims on the both sides of the coast, as it was later confirmed.

The Austro-Hungarian ultimatum came after all efforts failed to convince the Great Powers for a large collective demarche to Serbia. Russia openly supported the occupation of Albanian lands by Serbia, with France blaming Austria for the uprising of Albanians in Kosova. While, Italy was allied to Austria, it considered this conflict as the Austrian zone of influence. Given that a collective demarche of the Powers against Serbia could not be accomplished because of Russia's and France's objection, it could not bring any results, therefore a unilateral threat was more effective. The monarchy was forced to use this tactic against Montenegro and it had given positive results. This tactic carried the high risks because the cost monarchy would have to pay if failed was equal with consequences of war for all Europe and perhaps world. The second Austro-Hungarian ultimatum to Serbia few months later was similar to that of October 1913, but received a negative response from Serbia, and resulted with the Great Powers entering into what is known as the First World War.